



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve **Ilirian Feçi, Agim Gjini, Elvis Koçi (Çaushllari)**, etj...”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Ardit Mustafaj, Gerd Hoxha dhe Gilda Hoxha, me vendimin Nr. **77**, datë **20.12.2024** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ilirian Feçi** për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, në dëm të shtetasit S.R, ndodhur më datë 28.04.2011, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 139 dhe 28, pika 4, të K.Penal dhe duke u bazuar edhe në nenin 334, pika 1, të K.Penal dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ilirian Feçi** për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi parë, i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
 - Në bazë të nenit 55 të K.Penal, të pandehurit **Ilirian Feçi** i jepet një dënim i vetëm prej 10 (dhjetë) vjet burgim.
 - Në bazë të nenit 406, pika 1, të K.Pr.Penale, të pandehurit **Ilirian Feçi** i ulet një e treta e dënimit dhe dënohet përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.
 - Vuajtja e dënimit të pandehurit **Ilirian Feçi** i fillon nga dita e arrestimit, dhe të kryhet në një institucion të sigurisë së lartë.
- 2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Agim Gjini** për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, në dëm të shtetasit A.A, ndodhur më datë 31.05.2013, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 139 dhe 28, pika 4, të K.Penal dhe duke u bazuar edhe në nenin 334, pika 1, të K.Penal dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit **Agim Gjini** për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i dytë, i K.Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
 - Në bazë të nenit 55 të K.Penal, të pandehurit **Agim Gjini** i jepet një dënim i vetëm prej 10 (dhjetë) vjet burgim.

- Në bazë të nenit 406, pika 1, të K.Pr.Penale, të pandehurit **Agim Gjini** i ulet një e treta e dënimit dhe dënohet përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.
 - Vuajtja e dënimit të pandehurit **Agim Gjini** i fillon nga dita e arrestimit, dhe të kryhet në një institucion të sigurisë së lartë.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Elvis Koçi (Çaushllari)** për veprën penale “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasit S.S, ndodhur në vitin 2020, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 80 dhe 28, pika 4, të K.Penal dhe duke u bazuar edhe në nenin 334, pika 1, të K.Penal dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Elvis Koçi (Çaushllari)** për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i dytë, i K.Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
 - Në bazë të nenit 55 të K.Penal, të pandehurit **Elvis Koçi (Çaushllari)** i jepet një dënim i vetëm prej 6 (gjashtë) vjet burgim.
 - Në bazë të nenit 406, pika 1, të K.Pr.Penale, të pandehurit **Elvis Koçi (Çaushllari)** i ulet një e treta e dënimit dhe dënohet përfundimisht me 4 (katër) vjet burgim.
 - Vuajtja e dënimit të pandehurit **Elvis Koçi (Çaushllari)** i fillon nga dita e vënies në ekzekutim të vendimit duke mbajtur parasysh kohën e qëndrimit në masën e sigurimit “arrest në burg”, dhe të kryhet në një institucion të sigurisë së lartë.
4. Lidhur me provat materiale:
- telefonat celularë dhe pasaporta sekuestruar të pandehurit Agim Gjini, t’i kthehen atij.
5. Shpenzimet procedurale, të përbëra nga shpenzimet e hetimit paraprak dhe ato të gjyqimit, sipas përlllogaritjes nga sekretaria gjyqësore, u ngarkohen të pandehurve solidarisht.
6. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Tiranë, më datë 20.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar